



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIMIN

Nr. 65, datë 04.03.2021

MBI

**PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE PËR HEQJEN E LICENCAVE TË SHOQËRISË
“SANG 1” SH.P.K. PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE DHE PËR VEPRIMTARITË E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 8 dhe 9, të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.04.2017; nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 04.03.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 33/1 prot., datë 01.03.2021 të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

Konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 08, datë 20.01.2021, ka vendosur:

1. *Të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 443, seria P19, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., me vendimin e Bordit Nr. 83, datë 31.05.2019, i ndryshuar.*
2. *Shoqëria mund të paraqesë argumentet e saj me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.*
3. *Shoqëria “SANG 1” sh.p.k., duhet të shlyejë për llogari të ERE-s pagesat rregullatore për vitin 2020, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.*
4. *Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s*

Gjithashtu, me vendimin nr. 09, datë 20.01.2021 bordi i ERE-s ka vendosur:

1. *Të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 447, seria T19, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 26.06.2019.*
 2. *Shoqëria mund të paraqesë argumentet e saj me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.*
 3. *Shoqëria “SANG 1” sh.p.k., duhet të shlyejë për llogari të ERE-s pagesën rregullatore për vitin 2020 për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.*
 4. *Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.*
- Vendimmarrja sa më sipër u mor në kushtet kur shoqëria nuk plotësoi në afat kushtin e vendosur në vendimin e bordit të ERE-s nr. 83/2019, i ndryshuar me vendimin nr. 107/2019, për të depozituar në ERE dokumentacionin që vërteton mbështetjen financiare të shoqërisë për ndërtimin e impiantit prodhues, brenda 3 muajve nga marrja dijani e këtij vendimi. Po ashtu, ka rezultuar se shoqëria ka shitur 79% e kuotave, pa marrë autorizimin e ERE-s, siç përcaktohet në nenin 6.2, të Licencës së prodhimit të energjisë elektrike, si dhe të pikës 5.2, të Licencës së tregtimit të energjisë elektrike.
 - Për vendimin nr. 08/2021 dhe nr. 09/2021, ERE ka njoftuar shoqërinë nëpërmjet shkresës nr. 130 prot., datë 26.01.2021, e cila ka pasur 30 ditë kohë nga marrja e vendimit për t’u përgjigjur dhe dhënë me shkrim argumentet e saj.
 - Me depozitimin e deklaratës së shoqërisë “LAJTHIZA INVEST”, që ka marrë përsipër të mbështesë zbatimin e projektit dhe ndërtimin e HEC-it, duke u shoqëruar kjo dhe me pasqyrat financiare të kësaj shoqërie, nga të cilat konstatohet se kjo shoqëri ka aktivitet financiar pozitiv dhe aftësitë financiare për të mbështetur sa deklaruar, rezulton se shoqëria “SANG 1” sh.p.k., ka përmbushur kushtin e vendimit të pikës 2.2, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 107, datë 26.06.2019, «Për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 31.05.2019, “Mbi licencimin e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Thirrë” me kapacitet të instaluar 1.820 MW»».
 - Në lidhje me shitjen e 79% e kuotave, pa marrë autorizimin e ERE-s, siç përcaktohet në nenin 6.2, të Licencës së prodhimit të energjisë elektrike, si dhe të pikës 5.2, të Licencës së tregtimit të energjisë elektrike, shoqëria ka deklaruar se nuk ka kuptuar drejt detyrimin e saj për të marrë autorizimin e ERE-s për këtë procedurë dhe është mjaftuar me depozitimin e akteve përkatëse në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), duke shprehur angazhimin e saj për të mos anashkaluar kompetencat e ERE-s në lidhje me miratimin e ndryshimit të pronësisë mbi kuotat e të licencuarit.
 - Shoqëria “SANG 1” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për të marrë autorizimin e ERE-s për shitjen e 79% të kuotave të shoqërisë dhe ka depozituar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të marrë këtë autorizim nga ERE.

- Shoqëria “SANG 1” sh.p.k. ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj ERE-s për sa i përket pagesave rregullatore.
- Në nenin 9, gërma “a”, të *Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.58, datë 18.04.2017 parashikohet se *me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për:*
 - a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës
- Shoqëria “SANG 1” sh.p.k ka depozituar në afat dokumentacionin dhe shpjegimet përkatëse në lidhje me objektin për të cilin bordi i ERE-s nisi procedurat për heqjen e licencave të kësaj shoqërie, përkatësisht asaj të prodhimit të energjisë elektrike dhe të tregtimit të energjisë elektrike.
- Në nenin 113 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti administrativ nga vetë organi që ka nxjerrë aktin, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të përfundojë procedurën e nisur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 08, datë 20.01.2021, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 443, seria P19, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 83, datë 31.05.2019, i ndryshuar”.
2. Shfuqizimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 08, datë 20.01.2021, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 443, seria P19, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 83, datë 31.05.2019, i ndryshuar.
3. Të përfundojë procedurën e nisur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 09, datë 20.01.2021, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 447, seria T19, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 26.06.2019.

4. Shfuqizimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 09, datë 20.01.2021, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 447, seria T19, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 26.06.2019.
5. Shfuqizimin e pikës 2.2, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 107, datë 26.06.2019, “Për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 83, datë 31.05.2019, “Mbi licencimin e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Thirrë” me kapacitet të instaluar 1.820 MW”.
6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative, Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI